VENDIM
Nr. 211, datë 27.6.2023

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 250, DATË 13.12.2021, TË NDRYSHUAR, NË LIDHJE ME PLOTËSIMIN E KUSHTEVE TË LICENCIMIT NGA SHOQËRIA "SOT-AL" SHPK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 53, pika 2, dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 962/4 prot., datë 26.6.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 250, datë 13.12.2021, të ndryshuar, në lidhje me plotësimin e kushteve të licencimit nga shoqëria 'SOT-AL' sh.p.k.",

konstatoi se:

Në kuptim të vendimeve të Bordit të ERE-s nr. 250, datë 13.12.2021, i ndryshuar dhe nr. 268, datë 14.10.2022, shoqëria "SOT-AL" sh.p.k., ka detyrimin:

1. Të depozitojë në ERE brenda 3 (tre) muajve miratimin nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale,

2. Brenda 6 (gjashtë) muajve të depozitojë në ERE dokumentacionin pronësor, duke filluar ky afat nga data 14.9.2022.

3. Çdo 3 (tre) muaj të dokumentojë në ERE një progresraport me informacion për investimet që do të kryejë, në kuadër të plotësimit të kushteve të sipërcituara.

4. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë në përputhje me informacionin/ dokumentacionin e përditësuar sipas pikës 2 të këtij vendimi, apo aktet ligjore apo nënligjore të dala nga organet kompetente.

- Po ashtu, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 268, datë 14.10.2022, shoqërisë i është lënë detyrë që të paraqesë në ERE, në mënyrë periodike, me data të rifreskuara dokumentet që i nënshtrohen rinovimit të afateve.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë dhe seancës dëgjimore të mbajtur më datë 6.4.2023, në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 1, të vendimit nr. 250/2021, për depozitimin në ERE të miratimit nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale shoqëria ka sqaruar se Deklarata Mjedisore ka kufizuar praktikisht shtrirjen e zonës së projektit, ndaj është bërë e nevojshme që të ndërmerret një studim i ri. Kjo situatë kushtëzon marrjen e dokumentacionit pronësor, sepse do të sjellë zvogëlimin e sipërfaqes ku shtrihet projekti, kryerjen e studimit arkeologjik dhe procedimin për marrjen e miratimit të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Materiale.

- Shoqëria ka kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 250/2021, të ndryshuar, me 12–18 muaj.

- Duke qenë se procedurat për t'u pajisur me këto dokumente, që janë objekt i kushteve të vendimmarrjes së ERE-s nr. 250/2021, i ndryshuar, janë të ndërthurura me njëra-tjetrën dhe nuk varen vetëm nga vullneti i shoqërisë, pasi studimi i fizibilitetit duhet të ndiqet nga përditësimi i zonës ku do të shtrihet projekti dhe duhet të ndiqen procedurat në organet/institucionet kompetente të nivelit qendror ose lokal, sipas procedurave përkatëse, kërkesa për shtyrje vlerësohet e arsyeshme.

- Për gjithë sa më sipër, duke marrë në konsideratë angazhimin e shoqërisë për plotësimin e kushteve të vendimit nr. 250/2021, i ndryshuar, dhe po ashtu sa argumentuar nga ana e saj se për të

plotësuar kushtet e vendimit nr. 250/2021, i ndryshuar, duhet të bëhet fillimisht një studim i ri fisibiliteti, vlerësohet t'i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE brenda datës 30.6.2024 dhe brenda datës 31.12.2024 miratimin nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe dokumentacionin pronësor.

- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", parashikohet se: "Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 250, datë 13.12.2021, i ndryshuar, ndryshon si vijon:

1. Shoqëria "SOT-AL" sh.p.k. të depozitojë në ERE:

a) Studimin e ri të fizibilitetit brenda datës 30.6.2024;

b) Miratimin nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe dokumentacionin pronësor brenda datës 31.12.2024.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti